



GJYKIMI NË MUNGESË

– SIPAS LEGJISLACIONIT PËRKATËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Përgatitur nga Adea Boletini, me mentorim nga Amer Alija.

Në vitet e fundit, gjykimi në mungesë është bërë pjesë e rëndësishme e sistemit gjyqësor në Kosovë. Më 19 korrik 2019 hyri në fuqi Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili mundësoi zhvillimin e gjykimeve për krime lufte pa praninë fizike të të akuzuarit, përmes institutit të gjykimit në mungesë. Më 26 dhjetor 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë mori vendimin e parë të këtij lloji, duke e dënuar në mungesë me 15 vite burgim të akuzuarin Çedomir Aksiq për krime lufte të kryera gjatë periudhës janar-maj 1999 në komunën e Shtimes/Štimlje. Megjithatë, ky akt-gjykim u prish nga Gjykata e Apelit dhe, në fillim të vitit 2026, rasti u kthye në rigjykim në shkallën e parë. Ndërsa gjykimet në mungesë konsiderohen si një hap drejt garantimit të drejtësisë për viktimat, ato njëkohësisht ngrenë çështje të rëndësishme lidhur me efikasitetin e proceseve gjyqësore dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht sa i përket përputhshmërisë së tyre me standardet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Po ashtu, ky institut juridik ngre pikëpyetje edhe lidhur me ekzekutueshmërinë praktike të vendimeve të tilla. Ky hulumtim analizon rregullimin kushtetues dhe ligjor në Kosovë lidhur me parimet e gjykimit në mungesë të të akuzuarit në procedurën penale, duke e vendosur këtë institut në raport me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë, në veçanti me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Hyrje

Procesi ligjor ku një i pandehur gjykohet pa qenë fizikisht i pranishëm, respektivisht gjykimi në mungesë, ngre pyetje të rëndësishme në lidhje me ekuilibrin mes efikasitetit gjyqësor dhe mbrojtjes së të drejtave individuale. Kjo praktikë ka qenë objekt i një analize të gjerë në literaturën juridike, me studiues që shqyrtojnë implikimet e saj në sisteme të ndryshme ligjore dhe kornizën ligjore të të drejtave të njeriut.¹ Konteksti historik dhe bazat ligjore në lidhje me konceptin e gjykimit në mungesë ka rrënjë të thella historike, me pranimin dhe zbatimin e këtij koncepti që ndryshon varësisht nga traditat e ndryshme ligjore. Kjo analizë është hartuar si rezultat i përdorimit gjithnjë e më të shpeshtë të gjykimeve në mungesë në praktikën gjyqësore të Kosovës, veçanërisht pas ndryshimeve të fundit legjislative dhe zhvillimit të praktikës konkrete gjyqësore, përfshirë nxjerrjen e aktgjykimit të parë në mungesë në vitin 2024. Rritja e përdorimit të këtij mekanizmi në procedurat për krime lufte, e shoqëruar me debatet e vazhdueshme mbi përputhshmërinë e tij me standardet e gjykimit të drejtë, ka nxjerrë në pah nevojën për një analizë të strukturuar juridike të mbështetur në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, ky punim synon të kontribuojë në diskutimet juridike lidhur me gjykimet në mungesë, si dhe të shërbejë si mbështetje për praktikuesit e së drejtës, institucionet dhe palët e tjera të përfshira në administrimin e drejtësisë.

Historikisht, sistemet e së drejtës zakonore kanë hezitur të aplikojnë gjykimin në mungesë të të pandehurit, duke theksuar rëndësinë e pranisë së të akuzuarit për një gjykim të drejtë.² Për dallim nga kontekste që kanë zbatuar të drejtën zakonore, disa juridiksione të së drejtës civile kanë lejuar gjykime të tilla në rrethana specifike, duke reflektuar një qasje divergjente ndaj të drejtave të të pandehurve. E drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim penal është karakterizuar nga Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si “një nga të drejtat më themelore” të garantuara nga Kushtetuta.³ Rrjedhimisht, përputhshmëria e gjykimit në mungesë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut ka qenë një çështje e diskutueshme. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e ka trajtuar këtë çështje në disa raste, duke përcaktuar se përderisa gjykimet në mungesë nuk janë të ndaluara plotësisht, ato duhet të përmbahen kritereve strikte për të garantuar drejtësi.⁴ Vendimet e mëvonshme të GJEDNJ-së i kanë përforcuar këto parime, duke theksuar se një dënim në mungesë është në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) vetëm nëse shteti mund të tregojë se i akuzuari ishte në dijeni të procesit ose se ai hoqi dorë nga e drejta e paraqitjes.⁵ Tutje, GJEDNJ-ja theksoi se edhe kur gjykimet zhvillohen në mungesë, duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse procedurale për të siguruar që të pandehurit të kenë qasje në përfaqësimin ligjor dhe mundësinë për të kundërshtuar vendimin pasi të

1 James G. Starkey, “The Right to Be Present at Trial: Common Law and Modern Perspectives,” *St. John’s Law Review* 75, no. 3 (2001): 589-612.

2 Eugene L. Shapiro, “Due Process and the Absentee Defendant: A Constitutional Analysis,” *Marquette Law Review* 85, no. 4 (2002): 897-923.

3 *Taylor v. United States*, 414 U.S. 17 (1973).

4 *Colozza v. Italy*, App. No. 9024/80, European Court of Human Rights (1985).

5 *Sejdovic v. Italy*, App. No. 56581/00, European Court of Human Rights (2006).

mësohet për dënimin e tyre.⁶

Organe të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë vlerësuar gjithashtu çështjen e gjykimit në mungesë. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNHRC), në komentimin e tij të përgjithshëm nr. 32 mbi nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), ka deklaruar se gjykimet në mungesë janë të lejueshme vetëm nëse i pandehuri është informuar siç duhet për akuzat dhe procedurat (Mbenge kundër Zaire, 1977)⁷. Gjithashtu, Komisioni Afrikan për të drejtat e njeriut në rastin Zyra ligjore e Ghazi Suleiman kundër Sudanit theksoi se gjykimi i individëve në mungesë pa garancitë e duhura përbën një shkelje të të drejtave themelore të gjykimit të drejtë.⁸ Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut ka marrë një qasje të ngjashme strikte. Në rastin Loayza Tamayo kundër Perusë (1997), Gjykata konstatoi se praktika e qeverisë peruane për të dënuar individët në mungesë pa njoftim adekuat shkelte të drejtën e mbrojtjes sipas Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut.⁹ Ky vendim ripohoi se gjykimi në mungesë duhet të lejohet vetëm në rrethana të kufizuara kur i pandehuri ka ditur të drejtën e tij për të qenë prezent. Në të drejtën penale ndërkombëtare, debati për gjykimet në mungesë ka qenë veçanërisht i theksuar. Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC) ndalon gjykimet në mungesë, duke theksuar rëndësinë e pranisë së të akuzuarit. Megjithatë, disa gjykata ad hoc, si Gjykata Speciale për Libanin (STL), lejojnë gjykimet në mungesë nën kushte strikte (STL, 2011).¹⁰ STL e ka justifikuar këtë praktikë duke argumentuar se ajo parandalon mosdëshkimin në rastet kur të pandehurit e profilat të lartë i shmangen drejtësisë. Megjithatë, kritikët argumentojnë se gjykime të tilla rrezikojnë të minojnë standardet e gjykimit të drejtë dhe të drejtat e procesit të rregullt ligjor.

Juridiksionet dhe variacionet e brendshme në vende të ndryshme shfaqin qëndrime të ndryshme për gjykimet në mungesë, të ndikuar nga traditat e tyre ligjore dhe interpretimet e të drejtave të të pandehurve. Në Shtetet e Bashkuara, Gjykata e Lartë ka vendosur se mungesa vullnetare e një të pandehuri pas fillimit të gjykimit përbën heqje dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm, duke lejuar kështu gjykimin të vazhdojë (Crosby kundër Shteteve të Bashkuara, 1993).¹¹ Në të kundërt, Italia lejon gjykimet në mungesë më gjerësisht, megjithëse kjo praktikë është përballur me kritika nga organet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (Maleki kundër Italisë, 1996).¹²

Në kontekstin ligjor të Kosovës, Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta)¹³ dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ)¹⁴ që garantojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kërkojnë që çdo person të trajtohet drejtësisht në një proces gjyqësor dhe të

6 Medvedyev v. France, App. No. 3394/03, European Court of Human Rights (2010).

7 Mbenge v. Zaire, UN Human Rights Committee, Communication No. 16/1977.

8 Law Office of Ghazi Suleiman v. Sudan, African Commission on Human and Peoples' Rights.

9 Loayza Tamayo v. Peru, Inter-American Court of Human Rights (1997).

10 Special Tribunal for Lebanon, Decision on Conducting Trials in Absentia, Case No. STL-11-01/PT/AC/AR126.1 (2011).

11 Crosby v. United States, 506 U.S. 255 (1993).

12 Maleki v. Italy, UN Human Rights Committee, Communication No. 699/1996.

13 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

14 Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e ndryshuar nga Protokollat Nr. 11, 14 dhe 15, ETS Nr. 005, 4 nëntor 1950.

kenë mundësinë për t'u mbrojtur në mënyrë të barabartë dhe të hapur. Përkundër kësaj, gjykimi në mungesë (trial in absentia) shërben si një mjet i rëndësishëm procedural për të siguruar që drejtësia të mund të vazhdojë, edhe kur i akuzuari mungon, shpesh për shkak të arratisjes, shmangies nga arrestimi ose refuzimit për të marrë pjesë në gjykim. Megjithatë, që procedurat gjyqësore të zhvilluara në mungesë të të akuzuarit të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duhet të jenë ndërmarrë masa mbrojtëse, siç është të siguruarit që i akuzuari është njoftuar në mënyrë të duhur dhe mundësia e rishqyrtimit të çështjes ose ankimit.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në sistemin juridik të Kosovës në bazë të nenit 22 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], ka ritheksuar se, ndonëse kjo nuk është përcaktuar shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, qëllimi i përgjithshëm i këtij neni është që një person “i akuzuar për një vepër penale” të ketë të drejtën të marrë pjesë në seancë. Për më tepër, nënparagrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së garantojnë se “çdo i akuzuar për një vepër penale” ka të drejtë “të mbrohet personalisht”, “të marrë në pyetje ose të marrë në pyetje dëshmitarët” dhe “të ketë ndihmë falas të një përkthyesi nëse ai nuk mund të kuptojë ose të flasë gjuhën e përdorur në gjykatë”.

Sipas GJEDNJ-së, edhe pse gjykimet e mbajtura në mungesë të të akuzuarve nuk janë në thelb në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së, mohimi i drejtësisë ndodh kur një personi të dënuar në mungesë më vonë nuk i jepet mundësia për t'iu shqyrtuar rasti në merita, veçanërisht në rastet kur nuk është vërtetuar se i njëjti ka hequr dorë nga e drejta për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur.¹⁵

Në Republikën e Kosovës çështja e gjykimit në mungesë parashikohet me nenin 303 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i Procedurës Penale).¹⁶ Ky nen përcakton kushtet që duhen plotësuar për t'u zhvilluar gjykimi në mungesë si dhe të drejtën e personit të gjykuar në mungesë për një rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës.

Në vijim, shkurtimisht do të pasqyrohen gjashtë (6) rastet e GJEDNJ-së që ndërlidhen me gjykimin në mungesë, për të vazhduar më pas me një vlerësim të përputhshmërisë së dispozitave vendore me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

¹⁵ Shih, rastet e GJEDNJ-së Sanader kundër Kroacisë, nr. 66408/12, Aktgjykim i 12 shkurtit 2015; dhe Colozza kundër Italisë, nr. 9024/80, Aktgjykim i 12 shkurtit 1985).

¹⁶ Kodi Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i qasshëm ne: KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE.

QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRDORIMI I SYNUAR I ANALIZËS

Ky dokument është hartuar si një mjet referues për praktikuesit ligjorë, institucionet gjyqësore, politikëbërësit, aktorët e shoqërisë civile dhe palët ndërkombëtare të angazhuara në proceset e sundimit të ligjit dhe drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Ai synon të ofrojë një vlerësim të strukturuar juridik mbi gjykimet në mungesë, duke u fokusuar në përputhshmërinë e tyre me garancitë për gjykim të drejtë sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Analiza është hartuar për të mbështetur gjykatat dhe praktikuesit ligjorë në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave vendore në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të informuar diskutimet institucionale dhe reformat e mundshme ligjore lidhur me gjykimet në mungesë, si dhe për të kontribuar në debatet publike dhe profesionale mbi balancimin ndërmjet llogaridhënies dhe të drejtës për gjykim të drejtë, veçanërisht në procedurat për krime lufte.

Gjetjet e këtij punimi synohen t'u shpërndahen institucioneve relevante të drejtësisë, profesionistëve ligjorë dhe organizatave të shoqërisë civile. Dokumenti mund të publikohet gjithashtu si pjesë e përpjekjeve më të gjera të FDHK-së për promovimin e llogaridhënies dhe respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut. Hapat e ardhshëm mund të përfshijnë diskutime publike, prezantime apo angazhim të orientuar drejt politikëbërjes, bazuar në gjetjet e kësaj analize.

PËRMBLEDHJE E RASTEVE NGA PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Siç u theksua më lartë, KEDNJ nuk përcakton në mënyrë specifike se i akuzuari ka të drejtë të jetë i pranishëm në gjykimin e tij ose të saj, por në praktikën e saj Gjykata deklaroi se “objekti dhe qëllimi i nenit i marrë në tërësi është të sigurojë që një person i akuzuar për një vepër penale të ketë të drejtë të marrë pjesë në seancë. Përkundër kësaj, në lidhje me gjykimin në mungesë, në praktikën e saj gjyqësore, praktikë kjo e aplikueshme në Kosovë bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], GJED-

NJ ka zhvilluar dhe interpretuar kërkesat specifike dhe strikte në relacion me garancitë procedurale për gjykimin fer dhe të drejtë të përcaktuar me nenin Neni 6 të KEDNJ. Në vijim do të paraqitet përmbledhja e shkurtër e rasteve kryesore të kësaj praktike, duke theksuar kërkesat specifike dhe strikte në relacion me gjykimin fer dhe të drejtë e që ndërlidhet me gjykimin në mungesë. Përmbledhja e shkurtër e rasteve kryesore përfshinë faktet relevante të rastit, si dhe të gjetura/konstatimin e GJEDNJ-së.¹⁷

Rasti: Sejdiviq kundër Italisë [GC] - 56581/00

Aktgjykim i 1 marsit 2006 [GC]

Neni 6

Parashtruesi i kërkesës, shtetas i Gjermanisë, dyshohej për vrasjen e z. S. në një kamp udhëtarësh në Romë më 8 shtator 1992. Në këtë drejtim, më 15 tetor 1992, gjyqtari hetues në Romë urdhëroi ndalimin e tij në pritje të gjykimit. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës ishte i pagjurmueshëm, i njëjti u shpall “i arratisur”. Pasi që autoritetet italiane nuk arritën të kontaktojnë dhe informojnë parashtruesin e kërkesës se kishte mundësinë për të zgjedhur avokatin mbrojtës, atij iu caktua një avokat, i cili u njoftua se ndaj parashtruesit të kërkesës ishte caktuar seanca gjyqësore në Gjykatën Assize në Romë. Gjykimi u zhvillua në mungesë të parashtruesit të kërkesës dhe në të kishte marrë pjesë vetëm avokati i parashtruesit të kërkesës. Më 2 korrik 1996, Gjykata Assize në Romë e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për vrasje dhe armëmbajtje pa leje, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 21 vite e 8 muaj burgim. Kundër këtij vendimi, avokati i parashtruesit të kërkesës nuk paraqiti ankesë dhe i njëjti u bë i formës së prerë. Dy vjet e gjysmë më vonë, pas arrestimit të parashtruesit të kërkesës në Gjermani mbi bazën e urdhërarrestit të Zyrës së Prokurorisë Publike në Romë, Ministria e Drejtësisë e Italisë parashtrroi kërkesë për ekstradimin e tij nga Gjermania në Itali, përmes së cilës theksoi që parashtruesit të kërkesës, bazuar në nenin 175 të Kodit të Procedurës Penale, do t’i lejohej paraqitja e pasafatshme e ankesës kundër aktgjyimit të Gjykatës Assize në Romë. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë së Italisë u refuzua nga autoritet gjermane me arsyetimin se legjislacioni italian nuk garantonte mjaftueshëm që procedurat e zhvilluara në mungesë të tij mund të rihapen. Qeveria pretendoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike të parashikuara me nenet 670 dhe 175 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas Qeverisë, rrethanat faktike të rastit vërtetonin se parashtruesi i kërkesës qëllimisht kishte tentuar t’i shpëtonte gjykimin. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës i kundërshtoi pretendimet e Qeverisë duke theksuar se i njëjti nuk ishte informuar për ekzistencën e një mjeti juridik të brendshëm apo se ishte konsideruar “i arratisur” dhe se kishte procedurë penale në zhvillim kundër tij dhe më pas aktgjykim përmes të cilit ishte shpallur fajtor. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë pasi nuk ishte informuar për akuzat kundër tij dhe se autoritetet italiane kishin proceduar me supozimin se ai ishte fajtor për arsye se mungonte.

Në rastin e parashtruesit të kërkesës, sipas GJEDNJ-së, përderisa parashtruesi i kërkesës mund të përmbushte kushtin e parë dhe të vërtetonte se aktgjykimin me të cilin ishte shpallur fajtor nuk i ishte dorëzuar personalisht atij, përkitazi me kushtin e dytë, meqenëse i

17 Të gjitha rastet e GJEDNJ janë të qasshme në faqen zyrtare të GJEDNJ në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng>.

njëjti ishte bërë i pagjurmueshëm pas kryerjes së veprës penale, e cila kishte ndodhur në prani të dëshmitarëve okularë që e kishin akuzuar atë si përgjegjës, autoritetet italiane do të mund të vinin në përfundim se ai qëllimisht kishte dashur t'akuzohej; shpëtonte gjyqit. GJEDNJ konstatoi se pretendimet e Qeverisë nuk bazoheshin në ndonjë faktor objektiv tjetër përveç mungesës së parashtruesit të kërkesës nga vendbanimi i tij i zakonshëm, por në dritën e provave kundër tij dhe supozimit se i njëjti ishte i përfshirë në kryerjen e veprës penale. Në këto rrethana, GJEDNJ vlerësoi se nuk është dëshmuar se parashtruesi i kërkesës kishte njohuri të mjaftueshme për akuzat kundër tij, dhe se rrjedhimisht nuk mund të vihet në përfundim se i njëjti ka kërkuar t'akuzohej; shmanget gjykimit ose ka hequr dorë pa mëdyshje nga e drejta e tij për t'akuzohej; u paraqitur në gjykatë. Për më tepër, duke iu referuar legjislacionit italian i cili përcakton se kundërshtimi ndaj ekzekutimit është i pranueshëm vetëm kur konstatohet se ka pasur një parregullsi në procedurë që mund të bëjë të pavlefshëm vendimin, veçanërisht në lidhje me shërbimin e thirrjeve ndaj të pandehurve që nuk mund të gjurmohen, dhe faktit se në rastin e parashtruesit të kërkesës ftesa ishte dorëzuar në përputhje me ligjin e brendshëm, GJEDNJ konstatoi se përdorimi nga parashtruesi i kërkesës i mjetit juridik nga nenin 670 i Kodit të Procedurës Penale nuk do të rezultonte e suksesshme. Ndërsa, sipas GJEDNJ-së, mjete juridik i parashikuar në nenin 175 të Kodit të Procedurës Penale nuk kishte garantuar me siguri të mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës do të kishte mundësinë të merrte pjesë në një gjykim të ri për të paraqitur mbrojtjen e tij.

Si përfundim, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së pasi vlerësoi se parashtruesi i kërkesës i cili u gjykua në mungesë dhe nuk është dëshmuar se ka kërkuar t'akuzohej; shpëtojë gjykimit ose se ka hequr dorë pa mëdyshje nga e drejta e tij për t'akuzohej; u paraqitur në gjykatë, nuk ka pasur mundësinë për të marrë një vendim lidhur me akuzat kundër tij nga një gjykatë që e kishte dëgjuar në përputhje me të drejtat e tij.

Rasti: Sanader kundër Kroacisë - 66408/12

Aktgjykim i 12 shkurtit 2015

Neni 6

Në vitin 1992, ndërsa parashtruesi i kërkesës jetonte në pjesët e okupuara të Kroacisë në atë kohë, Zyra e Avokatit Publik në Sisak ngriti aktakuzë ndaj tij për veprën penale të krimeve të luftës, kundër të burgosurve të luftës. Gjykimi kundër tij u zhvillua në mungesë të tij, gjykim në të cilin i njëjti ishte përfaqësuar nga një avokat i caktuar përmes ndihmës juridike. Më 21 janar 1993, Gjykata Themelore në Sisak e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe i shqiptoi dënim me 20 vite burgim, duke u mbështetur në dëshmitë e 8 dëshmitarëve, të cilat avokati që i ishte caktuar nuk i kishte kundërshtuar. Vendimi i Gjykatës Themelore në Sisak, për sa i përket parashtruesit të kërkesës, u vërtetua nga Gjykata Supreme në vitin 2000 dhe më pas, në vitin 2004 kundër tij u lëshua udhërrëftues. Në vitin 2009, pasi parashtruesi i kërkesës kishte mësuar për dënimin e shqiptuar ndaj tij, kërkoi nga gjykatat kroate që të rihapnin procedurën, por kërkesa e tij u hodh poshtë nga Gjykata Supreme me arsyetimin se ai tani jetonte në Serbi dhe nuk ishte në dispozicion të autoriteteve kroate. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në Kroaci, kërkesës kjo e cila u shpallë e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese.

GJEDNJ theksoi se Qeveria i ishte referuar dy mekanizmave ligjorë sipas legjislacionit të brendshëm për rihapjen e procedurave, përkatësisht (i) paragrafit 2 të nenit 497 të Kodit të Procedurës Penale, i cili ofron një bazë specifike për rihapjen e procedurës gjyqësore të zhvilluar në mungesë, duke kërkuar nga personi i dënuar që të paraqitet para autoriteteve dhe të ketë një adresë banimi në Kroaci për kohëzgjatjen e procedurës; dhe (ii) nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 501 të Kodit të Procedurës Penale, që lejon një mundësi të përgjithshme rigjykimi. Sipas GJEDNJ-së, kërkesa që personat e gjykuar në mungesë të paraqiten para autoriteteve vendase dhe të ofrojnë adresë banimi në Kroaci, për të kërkuar rigjykim, ishte joproporcionale pasi në mënyrë efektive pengonte individët që jetonin jashtë Kroacisë të kërkonin rihapjen e procedurës pa u paraqitur para autoriteteve kroate. GJEDNJ vuri në dukje se sipas nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 501 të Kodit të Procedurës Penale, atij iu kërkuar të paraqiste prova të reja dhe domethënëse për të kundërshtuar vendimin përfundimtar për t'iu miratuar kërkesa për një rigjykim. GJEDNJ vlerësoi se parashtruesi i kërkesës, i gjykuar në mungesë, nuk kishte mundësi të kundërshtonte provat ose të apelonte kundër dënimit të tij dhe se kjo kërkesë ishte në disproporcion me të drejtën themelore për t'u paraqitur në gjykim dhe për të kundërshtuar provat. Rrjedhimisht, GJEDNJ konstatoi se kjo rrugë ligjore nuk i garantonte parashtruesit të kërkesës në mënyrë efektive një rigjykim. Si përfundim, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së pasi vlerësoi se parashtruesit të kërkesës, i cili u gjykua në mungesë dhe nuk është dëshmuar se ka kërkuar t'i shpëtojë gjyqit ose se ka hequr dorë pa mëdyshje nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë, nuk i është dhënë me siguri të mjaftueshme mundësia për të marrë një vendim të ri gjyqësor në merita lidhur me akuzat kundër tij.

Rasti: Einhorn kundër Francës (dhjetor) - 71555/01

Vendim i 16 tetorit 2001 [Seksioni III]

Neni 3 dhe 6

Parashtruesi i kërkesës, shtetas amerikan, u dënua në mungesë, me burgim të përjetshëm, për veprën penale të vrasjes në vitin 1993 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në tekstin e mëtejshëm: SHBA). I arrestuar në Francë në vitin 1997, një kërkesë fillestare e SHBA-së për ekstradimin e tij u refuzua nga autoritetet franceze për shkak të mungesës së të drejtave për rigjykim. Në vitin 1998, Pennsylvania ndryshoi legjislacionin për të lejuar rigjykim lidhur me dënimet e shqiptuara në mungesë. Pas kërkesës tjetër të SHBA-së për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, ku kishin ofruar garanci për një rigjykim të drejtë dhe mos-shqiptim të dënimit me vdekje, Gjykata e Apelit në Bordo dhe kryeministri francez miratuan ekstradimin. Parashtruesi i kërkesës e kundërshtoi vendimin për ekstradim, duke përmendur rreziqet e një dënimi të përjetshëm dhe ekspozimin ndaj dënimit me vdekje, por këto pretendime u hodhën poshtë pasi u vlerësua se autoritetet amerikane kishin ofruar garanci të mjaftueshme. Pas një tentative për vetëvrasje të parashtruesit të kërkesës dhe verifikimit të gjendjes mjekësore, u konfirmua se i njëjti mund të ekstradohej. Si rezultat, në vitin 2001, parashtruesi i kërkesës u transferua në SHBA.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së pasi sipas tij për-

ballej me një rrezik real për t#39;u d#228;nuar me vdekje dhe për t#39;u ekspozuar ndaj "fenomenit të d#228;nimit me vdekje"; q#228; p#228;rb#228;nte trajtim #228;njer#228;zor ose posh-t#228;rues. Ai gjithashtu pretendoi shkelje t#228; paragrafit 1 t#228; nenit 6 t#228; KEDNJ-s#228; si rezultat miratimit t#228; ekstradimit t#228; tij bazuar n#228; nj#228; ligj retroaktiv t#228; Pennsylvania-s, t#228; miratuar posaq#228;risht p#228;r t#228; ndikuar n#228; rezultatin e procedurave t#228; ekstradimit t#228; tij.

GJEDNJ e shpalli t#228; papranuesh#228;m pretendimin e parashtruesit t#228; k#228;rkes#228;s lidhur me nenin 3 t#228; KEDNJ-s#228;, me arsyetimin se autoritetet amerikane kishin dh#228;n#228; garanci se d#228;nimi me vdekje nuk do t#228; zbatohet dhe k#228;rkohej nga gjykata n#228; t#228; cil#228;n i nj#228;ti do t#228; rigjykohej. Nd#228;rkaq lidhur me pretendimin p#228;r shkelje t#228; nenit 6 t#228; KEDNJ-s#228;, GJEDNJ vler#228;soi se nuk mund t#228; konstatohej se parashtruesi i k#228;rkes#228;s nuk do t#228; kishte rigjykim n#228; SHBA ose se mohimi i drejt#228;sis#228; p#228;r t#228; cilin kishte frik#228; ishte flagrant. Sipas GJEDNJ-s#228;, Franca kishte p#228;rmbushur detyrimet e saj sipas nenit 6 t#228; KEDNJ-s#228; q#228; t#228; siguroj#228; nga autoritetet amerikane zotimin se parashtruesi i k#228;rkes#228;s nuk do t#228; vuante d#228;nimin q#228; i ishte shqiptuar n#228; munges#228;. Si rrjedhoj#228;, GJEDNJ e shpalli k#228;rkes#228;n e parashtruesit t#228; k#228;rkes#228;s t#228; papranueshme.

Rasti: Stoichkov kund#228;r Bullgaris#228; - 9808/02

Aktgjykim i 24 marsit 2005

Neni 5

Parashtruesi i k#228;rkes#228;s ishte larguar nga Bullgaria n#228; vitin 1988. I nj#228;ti u shpall fajtor dhe u d#228;nuar n#228; munges#228; nga Gjykata Themelore n#228; Pernik t#228; Bullgaris#228; p#228;r vepr#228;n penale t#228; p#228;rdhunimit dhe p#228;rdhunimit n#228; tentativ#228;, me nj#228; d#228;nim prej 10 vitesh burgim. Pas kthimit t#228; tij n#228; Bullgari n#228; vitin 2000, ai u arrestua p#228;r t#228; vuajtur d#228;nimin e shqiptuar. Parashtruesi i k#228;rkes#228;s paraqiti k#228;rkes#228; p#228;r lirimin e tij pran#228; Zyr#228;s s#228; Prokurorit t#228; Rrethit n#228; Pernik me pretendimin se afati 10 vje#228;ar i parashkrimit p#228;r zbatimin e d#228;nimit t#228; tij kishte skaduar, k#228;rkes#228; t#228; cil#228;n kjo e fundit e refuzoi me arsyetimin se afati i parashkrimit ishte nd#228;rprer#228;, s#228; fundmi n#228; vitin 1992. Ankesat e m#228;vonshme n#228; Prokurorin#228; Rajonale t#228; Pernikut, Prokurorin#228; e Apelit t#228; Sofjes dhe Prokurorin#228; e Lart#228; t#228; Kasacionit u hodh#228;n posht#228;, me arsyetimin se me veprime t#228; ndryshme p#228;rmbartimore, duke p#228;r-fshir#228; d#228;rgimin e nj#228; kopjeje t#228; vendimit n#228; polici n#228; vitin 1992 dhe l#228;shimin e nj#228; urd#228;h#228;r-k#228;rkitimi mbar#228;komb#228;tar n#228; vitin 1995, ishte nd#228;rprer#228; parashkrimi.

Parashtruesi i k#228;rkes#228;s pretendoi se arrestimi i tij n#228; vitin 2000 ishte i paligjsh#228;m dhe arbitrar. GJEDNJ vler#228;soi se pretendimi i parashtruesit t#228; k#228;rkes#228;s bie n#228;n fush#228;veprimin e paragrafit 1 t#228; nenit 5 t#228; KEDNJ-s#228;. Fillimisht, GJEDNJ theksoi se detyra p#228;r t#228; garantuar t#228; drejt#228;n e nj#228; t#228; pandehuri p#228;r t#228; qen#228; i pranish#228;m gjat#228; gjykimit renditet si nj#228; nga k#228;rkesat thelb#228;sore t#228; nenit 6 t#228; KEDNJ-s#228;. Sipas GJEDNJ-s#228;, n#228; rastin e parashtruesit t#228; k#228;rkes#228;s i cili u d#228;nuar n#228; munges#228;, nuk ka asnj#228; tregues se i nj#228;ti ka hequr dor#228;, shprehimisht ose n#228; heshtje, nga e drejta e tij p#228;r t#228; paraqitur dhe mbrojtur. Dhe se, n#228; m#228;nyr#228; q#228; procedurat q#228; #228;uan n#228; d#228;nimin e tij t#228; mos p#228;rfaq#228;sonin "mohim t#228; drejt#228;sis#228;";, ai duhet t#228; kishte pasur mund#228;sin#228; q#228; procedura t#228; rihapej. Prandaj, GJEDNJ konsideroi se procedura penale e zhvilluar kund#228;r parashtruesit t#228; k#228;rkes#228;s, dhe pamund#228;sia q#228; rasti t#228; d#228;gjohej s#228;rish, ishin haptazi n#228; kund#228;rshtim me parimet

e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së. Prandaj, GJEDNJ konstatoi se përderisa privimi fillestar i parashtruesit të kërkesës nga liria në shkurt të vitit 2000 mund të konsiderohet i justifikuar sipas pikës a të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së me qëllim të zbatimit të dënimit, justifikimi i privimit nga liria nuk vlen pas 19 korrikut 2001, kur Gjykata e Lartë e Kasacionit refuzoi rihapjen e procedurës. Ky përfundim e bën të panevojshëm përcaktimin nëse kërkuesi ishte burgosur pavarësisht skadimit të afatit të parashkrimit për ekzekutimin e dënimit të tij. Si përfundim, GJEDNJ konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së.

Rasti: Colozza kundër Italisë - 9024/80

Aktgjykim i 12 shkurtit 1985

Neni 6

Kundër parashtruesit të kërkesës ishte zhvilluar procedurë penale për veprën penale të mashtrimit. I njëjti ishte shpallur i arratisur nga autoritetet italiane dhe më vonë, në vitin 1975 u dënua në mungesë me 6 vite burgim nga Gjykata Rajonale në Romë. Pasi ky vendim mori formën e prerë, parashtruesi i kërkesës u arrestua dhe i njëjti dorëzoi kundërshtim procedural ndaj urdhërarrestit si dhe ankesë të pasafatshme kundër vendimit me të cilin ishte shpallur fajtor. Vendimi i Gjykatës Rajonale në Romë u vërtetua nga Gjykata e Apelit dhe më pas nga Gjykata e Kasacionit, me arsyetimin se ankesa ishte paraqitur jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

GJEDNJ theksoi se nuk mund të vërtetohej që parashtruesi i kërkesës ishte në dijeni të zhvillimit të procedurës penale ndaj tij, ishte konsideruar që ishte i njoftuar vetëm nëpërmjet dokumenteve të depozituara para gjyqtarit hetues. Sipas GJEDNJ-së, përpjekjet për gjetjen e tij ishin të pamjaftueshme, duke u fokusuar në adresa të vjetruara, pavarësisht se degët e tjera të prokurorisë dhe policisë e kishin marrë adresën e tij aktuale në procedura të veçanta. Në këtë drejtim, GJEDNJ theksoi se shtetet duhet të veprojnë me zell për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe se nuk kishte asnjë dëshmi që vërtetonte që parashtruesi i kërkesës kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të paraqitur ose po i shmangej drejtësisë. Më tej, GJEDNJ solli në vëmendje se parashtruesi i kërkesës sipas jurisprudencës italiane, kishte të drejtë të paraqiste ankesë jashtë afatit ligjor, të cilën e kishte bërë, por që Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit nuk e korrigjuan shkeljen e pretenduar pasi e para u kufizua në shpalljen e ankesës të papranueshme dhe e dyta arriti në përfundimin se shpallja e tij si i arratisur ishte legjitime. Rrjedhimisht, GJEDNJ konstatoi se çështja e parashtruesit të kërkesës nuk u dëgjua kurrë, në praninë e tij, nga një "tribunal" i cili ishte kompetent për të përcaktuar të gjitha aspektet e çështjes. GJEDNJ poashtu refuzoi pretendimin e se parashtruesi i kërkesës kishte qenë përgjegjës për të informuar autoritetet për ndryshimin e adresës së tij, posaçërisht pasi ishte shpallur i arratisur, duke theksuar se i njëjti nuk mund të bënte një gjë të tillë pasi nuk vërtetohet se ai ka qenë në dijeni për procedurën e inicuar kundër tij. Si përfundim, GJEDNJ vlerësoi se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Rasti: Yeger kundër Turqisë – 4099/12

Aktgjykim i 7 qershorit 2022

Neni 5 dhe 6

Parashtruesi i kërkesës ishte dënuar në mungesë më 7 nëntor 2009 nga Gjykata Penale e Shkallës së Parë të Stambollit për lëshimin e një çeku të pambuluar, sipas nenit 16 (1) të ligjit përkatës. Pas disa tentativave për dorëzim të Aktgjykimit, i njëjti u dorëzua në adresën e tij të banimit më 2 dhjetor 2009 dhe u bë i formës së prerë më 10 dhjetor 2009 pa apelim. Parashtruesi i kërkesës u arrestua më 30 mars 2011 për të vuajtur dënimin. Më 25 prill 2011, ai dorëzoi kërkesë për rigjykim, duke pretenduar se nuk kishte qenë në dijeni të procesit pasi kishte qenë jashtë vendit nga korriku 2008 deri në korrik 2009. Më 3 maj 2011, gjykata gjegjëse e refuzoi kërkesën e tij me arsyetimin se dokumentacioni ishte dorëzuar në adresën e tij. Avokati i parashtruesit të kërkesës më tej parashtroi ankesë përmes së cilit kërkoi shpalljen e pavlefshme të vendimit me të cilin ky i fundit ishte dënuar, duke argumentuar mungesën e vetëdijes së tij për procedurat. Megjithatë, më 6 tetor 2011, ankesa e tij u refuzua për shkak të mos- paraqitjes së ankesës brenda afatit ligjor prej 7 ditësh.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se nuk ishte në dijeni të procedurës penale kundër tij dhe se nuk kishte marrë asnjë dokument lidhur me të, përfshirë vendimin me të cilin ishte dënuar. Sipas parashtruesit të kërkesës, ai nuk mund të kishte informuar autoritetet për ndryshimin e adresës, pasi ai nuk dinte për procedurat që ishin duke u zhvilluar kundër tij dhe nuk mund të ankohej brenda afatit ligjor. Në anën tjetër, Qeveria pretendoi se autoritetet ndërmorën hapat e nevojshëm për ta njoftuar atë. GJEDNJ theksoi se nuk kishte provë objektive që të sugjeronte se parashtruesi i kërkesës kishte njohuri efektive për procedurat, se po i shmangej qëllimisht drejtësisë ose kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të paraqitur. Në këtë aspekt, GJEDNJ vlerësoi se gjykatat vendase nuk vlerësuan dhe verifikuan në mënyrë adekuate nëse parashtruesi i kërkesës ishte informuar dhe se dështimi për të përditësuar adresën e tij ishte i pamjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ai kishte njohuri për rastin. Rrjedhimisht, GJEDNJ arriti në përfundimin se parashtruesit të kërkesës iu mohua mundësia për të marrë një vendim të ri të çështjes së tij, duke shkelur të drejtën e tij për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ poashtu konstatoi shkelje të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së, pasi vlerësoi se privimi nga liria i parashtruesit të kërkesës për të vuajtur dënimin që rrjedh nga një dënim që rezulton me mos- respektim të kërkesave procedurale nga neni 6 i KEDNJ-së, nuk mund të konsiderohet “i ligjshëm” sipas pikës a të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së.

PËRFUNDIM

Neni 303 i Kodit të Procedurës Penale rregullon gjykimin në mungesë, duke përcaktuar kushtet për njoftimin e të akuzuarit dhe sigurimin e mbrojtjes së tij përmes një avokati. Përmes kësaj dispozite lejohet gjykimi në mungesë, për sa kohë janë bërë përpjekje të arsyeshme për njoftim dhe gjithashtu parashihet e drejta për një rigjykim të plotë dhe automatik nëse kërkohet nga i akuzuari.

Fillimisht, sipas paragrafit 2 të këtij neni i akuzuari mund të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor në rastet (i) kur i akuzuari ka marrë pjesë në seancën fillestare dhe është informuar për datën e shqyrtimit nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, ose gjatë ndonjë seance tjetër gjyqësore, ku është njoftuar për detyrimin e prezencës dhe për faktin se gjykimi mund të vazhdojë nëse ai nuk paraqitet; dhe (ii) nëse ka qenë i pranishëm në gjykim, por nuk ka paraqitur më veten në seancat e mëvonshme, edhe pasi është informuar për datën e re të shqyrtimit. Në këto raste, sipas paragrafit 3 të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale gjykata përcakton nëse mungesa është vullnetare dhe, në rast se po, i akuzuari mund të përfaqësohet nga avokati mbrojtës.

Tutje, sipas paragrafit 5 të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale, kur gjykata përcakton se i akuzuari ka vendosur vullnetarisht të mungojë, e njëjta, për të vijuar me shqyrtimin në mungesë shqyrton (i) vështirësinë e shtyrjes; (ii) barrën mbi prokurorinë; dhe (iii) mundësinë që vonesa të krijojë vështirësi për dëshmitarët e prokurorisë. Paragrafi 6 i nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale përcakton se nëse gjykimi zhvillohet pa praninë e të akuzuarit, gjykata bën përpjekje për ta njoftuar atë për aktgjykimin dhe se kur kjo është e pamundur, mbrojtësi mund të bëjë ankesë në emër të tij, siç përcaktohet në nenin 380 dhe 383 të të njëjtit Kod.

Paragrafi 7 i nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale parasheh se në rastet e veprave penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal (veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe vrasjes së rëndë), gjykimi në mungesë mund të mbahet edhe pa u plotësuar kriteret e parapara në këtë nen për praninë e të akuzuarit, nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues bindet se janë bërë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar të akuzuarin për shqyrtimin gjyqësor dhe për ta siguruar praninë e tij.

Në lidhje me paragrafin 7 të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale i cili parasheh gjykimin në mungesë për vepra penale të përcaktuara në nenin 104 të Kodit Penal, me kusht që janë bërë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të akuzuarin dhe për të siguruar praninë e tij si dhe përfaqësimin e të akuzuarit nga një avokat gjatë tërë procedurës, sipas praktikës së GJEDNJ-së, kërkohet (i) që shteti të bëjë përpjekje të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të njoftuar të akuzuarin për procedurat gjyqësore; (ii) që një i akuzuar

i gjykuar në mungesë të ketë një mbrojtës efektiv. Në këtë aspekt, mund të thuhet se përcaktimet në këtë paragraf janë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mirëpo shteti duhet të sigurojë që mbrojtja e ofruar nga avokati i caktuar në mungesë të jetë efektive dhe jo thjesht formale.

Më tej, paragrafi 8 i nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale përcakton përpjekjet e arsyeshme për njoftimin e të akuzuarit, duke përfshirë procedurat sipas neneve 172 dhe 173 të të njëjtit Kod dhe një fushatë informative të plotë, duke e thirrur të akuzuarin të dorëzohet në juridiksionin e gjykatës, publikimin e akuzave në faqet zyrtare, dhe thirrjes të çdo personi që ka informacion relevant për vendndodhjen e të akuzuarit që t'ia komunikojë atë informacion policisë. Në këtë drejtim, GJEDNJ thekson se njoftimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe i drejtpërdrejtë. Rrjedhimisht, publikimet në ueb faqe dhe gazeta zyrtare mund të mos jenë gjithmonë të mjaftueshme dhe të drejtpërdrejta. Efektiviteti i përpjekjeve për njoftim mund të vihet në pikëpyetje nëse mjetet e përshkruara nuk sigurojnë realisht informimin e të akuzuarit.

Sipas paragrafit 9 të nenit 303 të Kodit të Procedurës Penale, një person i gjykuar sipas paragrafit 7 të po të njëjtit nen ka të drejtë në rigjykim të pakushtëzuar, automatik e të plotë sipas kërkesës. Lidhur me këtë, GJEDNJ e konsideron të drejtën për një rigjykim të plotë si një garanci thelbësore për pajtueshmërinë e gjykimeve në mungesë me KEDNJ. Rrjedhimisht, kjo dispozitë, në parim, është në përputhje të plotë me këtë standard, pasi garanton një rishqyrtim të plotë dhe të drejtë të çështjes. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përcakton ndonjë afat kohor lidhur me rishqyrtimin e çështjes ndërkaq që sipas GJEDNJ-së, personi i dënuar në mungesë duhet të marrë një gjykim të ri pa vonesa nëse ai ose ajo kërkon një të tillë (shih, rastet e GJEDNJ-së Sejdiviq kundër Italisë, nr. 56581/00, Aktgjykim i 1 marsit 2006, paragrafi 125; Gençel kundër Turqisë, nr. 53431/99, Aktgjykim i 23 tetorit 2003, paragrafi 27).

GJETJET KRYESORE

Bazuar në analizën e mësipërme, mund të theksohen këto gjetje kryesore:

Korniza ligjore e Kosovës lejon gjykimet në mungesë dhe përfshin disa garanci mbrojtëse, përfshirë të drejtën për rigjykim, të cilat në përgjithësi janë në përputhje me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Njoftimi i të akuzuarit mbetet një çështje thelbësore shqetësuese, pasi metodat indirekte apo thjesht formale mund të mos e përmbushin kërkesën e GJEDNJ-së që i akuzuari të ketë dijeni reale për procedurat.

Roli i mbrojtësit është thelbësor dhe garancitë duhet të sigurojnë që përfaqësimi të jetë efektiv dhe jo vetëm formal.

Gjykimet në mungesë duhet të zbatohen në përputhje të rreptë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të përdoren vetëm si masë e fundit, në mënyrë që të parandalohet shndërrimi i tyre në një praktikë rutinore apo thjesht formale. Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme në pritje të anëtarësimit të ardhshëm të Kosovës në Këshillin e Evropës, kur procedura të tilla mund t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe sfidimit të mundshëm para GJEDNJ-së.

Projekti “Ballafaqimi me Trashëgiminë e Konfliktit” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.



**British Embassy
Pristina**



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo